**BASHKIA TIRANË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE**

# PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6-18 MUAJSH




PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

# Kuriozitete për muajin Prill



## Çfarë duhet të dimë për muajin Prill?

* Muaji Prill është muaji i dytë i stinës së pranverës.
* Prilli është muaji i luleve, i ngjyrës së gjelbër dhe i poezisë.
* Muaji Prill shënon Ditën Ndërkombëtare të Zogjve.
* Muaji Prill është muaji i ndërgjegjësimit për librin.
* Në muajin Prill është Dita e Balonave.









**Muaji Prill - Tema: Qyteti dhe fshati**

**Grupi: 6-18 muajsh**

* **Java I**: Elementët e qytetit
* **Java II**: Elementët kryesorë të fshatit
* **Java III**: Njohja me mjetet e transportit
* **Java IV**: Respektojmë rregullat në komunitet

| Tema mujore: Qyteti dhe fshati | | |
|---|---|---|
| **Temat Javore** | **Qëllimi** | **Koha e realizimit** |
| **Njohja me elementët kryesorë të qytetit** | Njohja me elementët kryesorë të qytetit si: lagjet, pallatet, rrugët, parqet. | Java I |
| **Njohja me elementët kryesorë të fshatit** | Njohja me disa elementë kryesore si: fusha, pylli, ferma, etj. | Java II |
| **Njohja me mjetet e transportit** | Njohja me mjetet e transportit. | Java III |
| **Respektojmë rregullat në komunitet** | Njohja me rregullat e komunitetit ku banojmë. Njohja me rregullat në çerdhe. | Java IV |

**Shënim:**

* **Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim përvetësimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.**
* **Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.**

**Tema mujore: Qyteti dhe fshati**

**Tema e javës: Njohja me qytetin**



| Java I | Rubrika | Aktivitetet | Mjetet e Punës |
|---|---|---|---|
| **E Hënë** | Qyteti ynë<br> | 1. **Identifikimi me gisht dhe emërtimi:** Edukatoret përdorin figura të printuara dhe/ose revista, libra për të treguar elementët e qytetit: pallat, park, muze, cirk, teatër, spital etj.<br>2. **Vjersha:** “Shtëpia e bubit”<br>3. **Kënga:** “Hapa dollapa” | Foto të printuara<br>Revista<br>Libra<br> |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Manuali i Vjershave   |
| **E Martë** | Ndërtojmë me kuba | 1. **Tapeti/Tabela ndijore:** Edukatorja nxit fëmijët të prekin copat e tapetit ndijor; Edukatorja emërton përbërjen e secilit material si dhe ndjesinë që përcjell kur preket: e fortë, e butë, e ashpër etj.<br><br>2. **Loja:** "Merre ti kubin". Edukatorja luan me kuba së bashku me fëmijët duke emërtuar ngjyrat e kubave të përdorur. | Copë<br>Karton |

| | | | |
|---|---|---|---|
| |  | **3. Kënga:** “Hapa dollapa” | Materiale të përbërjeve të ndryshme<br><br> |
| **E Mërkurë** | Këndet e lojërave<br> | **1. Identifikimi me gisht dhe emërtimi:** Edukatoret përdorin figura të printuara si: lisharëse, rrëshqitëse për t’u folur fëmijëve rreth këndit të lojrave. Gjithashtu, mund të përdoren për konkretizim lodra të tilla nëse ka në ambjentet e çerdhes.<br><br>**2. Kënga:** “Hapa dollapa”<br><br>**3. Loja:** Luajmë me flluska sapuni | Foto të printuara<br>Lodra<br>Manuali i Vjershave<br> |
| **E Enjte** | Zogu me punë dore | **1. Punë dore:** Krijimi i zogjve me kartona, letra me ngjyra apo materiale të tjera. Zogjtë ngjiten në shkopinj, për t’ua treguar fëmijëve, shoqëruar me tingujt e zogjve apo këngë.<br><br>**2. Loja:** Imitmi i tingujve të zogjve | Manuali i Vjershave<br>Letra me ngjyra<br>Kartona<br>Ngjitës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| |  | **3. Këngë lëvizore:** “Duart nga e majta…”; “Nëse ndihesh i gëzuar…” etj. | |
| **E Premte** | Kafshët shtëpiake  | **1. Identifikimi dhe emërtimi:** Edukatoret identifikojnë dhe emërtojnë kafshët shtëpiake duke përdorur figura të printuara dhe lodra.<br><br>**2. Loja:** “Imitimi i tingujve të kafshëve shtëpiake”<br><br>**3. Vjersha:** “Shtëpia e bubit”<br><br>**4. Përralla:** Pula Ema | Manuali i Vjershave<br>Foto të printuara<br>Libra<br>Lodra<br><br> |

| Tema e javës: Njohja me fshatin  | | | |
|---|---|---|---|
| **Java II** | **Rubrika** | **Aktivitetet** | **Mjetet e Punës** |
| **E Hënë** | Fshati  | 1. **Identifikimi dhe emërtimi:** Edukatorja tregon dhe emërton figura me pamje nga fshati si fusha, mali etj. Edukatorja mund të përdor foto të printuara dhe/ose libra, revista.<br><br>2. **Loja sensore**:<br><br>a. Shishe e mbushur me oriz të ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër (foto në të djathtë)<br><br>ose<br><br>b. Qese me bar natyral (foto në të djathtë)<br><br>3. **Kënga:** "Qingji vogël" | Foto<br>Qese me mbyllje hermetike<br>Ngjitës   |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **E Martë** | Kafshët në fshat<br> | **1. Bisedë:** Eduktorja identifikon dhe emërton kafshët që jetojnë në fermë/fshat. Identifikimi dhe emërtimi duke përdorur lodrat.<br><br>**2. Kënga:** “Fermeri ka një fermë…”<br><br>**3. Lojë:** Imitimi i tingujve të kafshëve ose libra me tingujt e kafshëve. | Lodra<br>Libra<br><br> |
| **E Mërkurë** | Shpendët  në fshat<br> | **1. Bisedë:** Edukatorja identifikon shpendët në foto/lodra dhe emërton shpendët e identifikuara: pula, gjeli, zogu, pata, rosa.<br><br>**2. Vjersha:** “Rosaku”<br><br>**3. Loja**: Imitimi i tinguje të shpendëve<br><br>**Loja sensoriale:** Shishe plastike të mbushura me kokrra misri, ose kokrra gruri. | Foto të printuara<br>Lodra<br>Shishe<br>Misër<br>Grurë<br> |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **E Enjte** | Lojë sensoriale me bojra<br> | 1. **Lojë sensoriale:** Edukatoret krijojnë mundësinë që fëmijët të pikturojnë me gishta. Në një qese me mbyllje hermetike, hidhen disa pika bojë të një ngjyre apo të ngjyrave të ndryshme. Më pas këto ngjiten me ngjitës në tavolinë.<br><br>2. **Kënga:** "Qingji vogël"<br><br>3. **Përralla:** Qengji Nina | Libër me përralla<br><br>Bojra<br>Qese me mbyllje hermetike<br>Ngjitës |
| **E Premte** | Krijimi i kafshëve dhe shpendëve me punë dore<br> | 1. **Punë dore:** Krijimi i kafshëve dhe shpendëve me karton, ngjitja e tyre. Edukatorja u tregon fëmijëve kafshët dhe shpendët, duke i vendosur në gishta.<br><br>2. **Kënga:** "Fermeri ka një fermë…"<br><br>3. **Vjersha**: "Rosaku" | Manuali i vjershave dhe këngëve<br>Kartona me ngjyra<br>Ngjitës<br> |

**Tema mujore: Qyteti dhe fshati**

**Tema e javës: Mjetet e transportit**



| **Java III** | **Rubrika** | **Aktivitetet** | **Mjetet e Punës** |
|---|---|---|---|
| **E Hënë** | Njohja me mjetet e transportit<br> | 1. **Identifikimi dhe emërtimi:** Edukatorja identifikon dhe emërton mjetet e transportit duke përdur lodra për secilën kategori (uji, tokë, ajër).<br>2. **Kënga**: “Autobusi”<br>3. **Loja**: Imitojmë tingujt e mjeteve të transportit | Mjetet e transportit lodër<br><br> |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **E Martë** | Njohja e mjeteve të transportit nëpërmjet lojës  | 1. **Loja sensore:** Rruga e makinës me qesen me flluska ajri. Fëmijët të luajnë me makina mbi të, të ecin këmba doras, apo të shtypin flluskat me gisht (foto në të djathtë).<br>2. **Kënga:** "Autobusi"<br>3. **Vjersha: "**Treni" | Qese me flluska ajri<br>Ngjitës   |
| **E Mërkurë** | Mjetet e transportit tokësor  | 1. **Aktivitet:** Makina me gjurmën e këmbës. Edukatoret duke përdorur bojra dhe penela realizojnë gjurmën e këmbës në fletë formati ose karton, për disa nga fëmijët.<br>2. **Kënga:** "Autobusi"<br>3. **Vjersha:** "Treni" | Bojra<br>Penela  |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **E Enjte** | Mjetet e transportit ajror dhe ujor<br><br> | 1. **Vjersha:** “Marinari”<br><br>2. **Loja**: Varka me sfungjer lundron mbi ujë. Edukatoret krijojnë varka të vogla prej sfungjeri dhe i vendosin në një enë me ujë. Edukatoret nxitin fëmijët të prekin varkat.<br><br>3. **Përralla**: Klouni Birilo | Sfungjer<br>Ujë<br><br> |
| **Premte** | Balona<br> | 1. **Vjersha**: “Treni”<br><br>2. **Kënga:** “Autobusi”<br><br>3. **Aktivitet:** Krijimi i balonës me gjurmën e dorës. Secili fëmijë me ndihmën e edukatores krijon balonën me gjurmën e dorës si modeli në foton djathtas. | Fletë formati A4<br>Bojra<br>Penela<br>Manuali i Vjershave dhe Këngëve<br> |

**Tema mujore: Qyteti dhe fshati**

**Tema e javës: Respektojmë rregullat në komunitetit**

| Java IV | Rubrika | Aktivitetet | Mjetet e Punës |
|---|---|---|---|
| **E Hënë** | Rregullat e sjelljes në çerdhe<br> | 1. **Bisedë**: Edukatorja përmend disa nga rregullat në çerdhe duke i konkretizuar me foto, si psh:<br>a. *Lajmë duart me ndihmën e edukatores.*<br>b. *I ndajmë lodrat me njëri-tjetrin.*<br>c. *Mbledhim lodrat, pasi përfundon loja etj.*<br><br>2. **Aktiviteti 1:** Mbledhja e lodrave pas lojës dhe vendosja e tyre (me nihmën e edukatores) në kosh/kuti.<br><br>3. **Aktiviteti 2:** Shkëmbejmë lodrat me njëri-tjetrin. Eukatorja nxit fëmijët dy e nga dy, të japin-marrin lodra nga njëri-tjetri.<br><br>4. **Kënga: "**Xhepi im i vogël" | Lodra<br>Kuti<br><br> |
| **E Martë** | Semafori | 1. **Vjersha:** "Xhepi im i vogël" | Kartona me ngjyra<br>Ngjitës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| |  | **2. Aktivitet:** Ngjyrat e semaforit ngjitur mbi tavolinë/parket ose te pjesa e poshtme e murit që fëmijët mund t'i shohin dhe prekin (foto në të majtë).<br><br>**3. Loja**: Loja me topa të ngjyrave: të gjelbër, të verdhë, të kuq. Topat ngjiten me ngjitës në mur dhe të nxiten fëmijët për t'i kapur dhe hequr nga muri (foto në të djathtë). |  |
| **E Mërkurë** | Natyra e bukur<br> | **1. Identifikimi dhe emërtimi:** Edukatorja u tregon fëmijëve dhe emërton elementë të natyrës si: pema, gjethja, lulja, bari etj. Për këtë mund të përdoren foto të printuara ose libra, revista.<br><br>**2. Vjersha:** "Mos e këput lulen"<br><br>**3. Loja sensoriale**: Gjethe natyrale ose prej letre. Në qese me mbyllje hermetike vendosen gjethe natyrale ose prej letre. Këto qese ngjiten mbi parket/tavolinë/pjesa e poshtme e murit, që fëmijët mund t'i prekin dhe shohin (foto në të djathtë). | Gjethe natyrale<br>Gjethe prej letre<br>Ngjitës<br> |
| **E Enjte** | Fjalët magjike | **1. Bisedë**: Edukatoret emërtojnë disa nga fjalët magjike. Gjithashtu, në mënyrë të | Manuali i Vjershave |

| | | | |
|---|---|---|---|
| |  | vazhdueshme përdorin fjalët magjike në komunikim me fëmijët.<br><br>2. **Vjersha:** “Xhepi im i vogël”<br><br>3. **Kënga:** “Fjalët magjike”<br><br>4. **Përralla:** Treni i vogël i fshatit | Libër me përralla<br> |
| **E Premte** | Krijimi i luleve<br> | 1. **Punë dore:** Krijimi i Lule Deles me adeziv ose karton/letra dhe ngjitja mbi parket/tavolinë e disa luleve.<br>Ose<br><br>2. **Lojë sensoriale:** Qese me lule natyrale Në një qese transparente vendosen lule të ndryshme dhe ngjitet mbi tavolinë ose parket.<br><br>3. **Vjersha:** “Mos e këput lulen”<br><br>4. **Kënga: “**Fjalët magjike” | Letra adeziv/karton me ngjyrë të bardhë dhe të verdhë<br>Qese hermetike<br>Lule natyrale<br>Manuali I Vjershave<br> |